



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 11128/5 Prot.

Tiranë, më 15/12/2017

V E N D I M

Nr. 173, Datë 15/12/2017

PËR

AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR
NË PROKURORINË E PËRGJITSHME, "MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE VJETORE TË INSTITUCIONIT".

Nga auditimi i ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme, mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare për vitin 2016 dhe transaksionet financiare deri në 30.10.2017, rezultoi se, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të institucionit, më datë 31.12.2016. Gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura, edhe pse nuk kanë ndikim material¹, synojnë përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit*" të ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme sipas programit të auditimit nr. 1112/1 prot, datë 01.11.2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 30.10.2017

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

¹ Referuar ISSAI 1320: Gabimet (shmangiet) konsiderohen materiale nëse pritet në mënyrë të arsyeshme që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e pasqyrave financiare.

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; manualin e auditimit financiar të KLSH; dhe me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (*ISSAI 1700², dhe ISSAI 1200³*). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Sipas kërkesave etike, të cilat janë të përshtatshme për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të besueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Në vijim kemi kryer procedurat analitike dhe teste të detajeve, pas vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për të arritur nivelin e kërkuar të sigurisë së arsyeshme⁴, që na lejon të shprehim një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Opinion i pakualifikuar:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Prokurorisë së Përgjithshme, për periudhën 01.01 – 31.12.2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*), pagesave në para, pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Nën gjykimin tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Prokurorisë së Përgjithshme më datën 31 Dhjetor 2016, gjendjen financiare dhe flukset e parasë për vitin ushtrimor 2016, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë raportimin financiar".

B. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi nr. 1:

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë periudhës objekt auditimi, Institucioni ka vijuar të mbështetet në planin strategjik 2015-2017. Ky plan nuk është rishikuar në mënyrë periodike dhe më pas miratuar nga nëpunësi autorizues i njësisë publike, duke reflektuar objektivat strategjikë, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale, sikundër kërkohet në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave. Mos rishikimi i Planit Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos rishikimin e vazhdueshëm të objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve, që duhet të

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

⁴ Niveli i pranuar i sigurisë së arsyeshme është 95%.

realizohen përmes proceseve të punës. Sa më sipër gjithashtu ndikon në mos përcaktimin e qartë të proceseve të punës.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 në Raportin përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi 1.1:

Institucioni të marrë masa për të hartuar Planin Strategjik, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 2:

Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka vijuar të funksionojë me rregulloren e brendshme të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 46/3 datë 27.01.2015 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme*”, edhe pse gjatë periudhës objekt auditimi, ka pasur ndryshime në strukturë si, krijimi i pozicioneve të reja apo sektorëve të rinj. Nga auditimi u konstatua se, këto ndryshime vijnë në mos reflektohen në rregulloren e institucionit sikundër kërkohet në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar). Mos rishikimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbart rrisje që lidhen me mos përcaktimin e rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të ndryshme të punës. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 në Raportin përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandimi 2.1:

Institucioni të marrë masa për të reflektuar në Rregulloren e Brendshme, ndryshimet e ndodhura në strukturë, për të ndihmuar punonjësit e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre. Sa më sipër në funksion të kryerjes së detyrave dhe realizimit të objektivave të institucionit.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi nr. 3:

Nga auditimi u konstatua se, edhe pse është ngritur GMS për vitin 2017 mungon dokumentimi i takimeve të realizuara apo problematikat e trajtuara, duke mos ofruar kështu siguri të arsyeshme mbi kryerjen ose jo të mbledhjeve të GMS-së, sikundër kërkohet në pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16 datë 16.07.2016 “*Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar..dhe në mbështetje të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar). Dokumentimi në vetvete, përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera⁵. Mos dokumentimi i mbledhjeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik, rrezikon procesin e gjurmimit të vendimeve të marra gjatë takimeve të grupit me qëllim zbatimin e tyre. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

⁵ Referuar Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Rekomandimi 3.1:

Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa mbi dokumentimin e mbledhjeve, dhe çështjeve/problematikave të trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, me qëllim gjurmimin e vendimeve të marra përgjatë takimeve të grupit dhe ndjekjen e zbatimit e tyre.

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 4:

Nga auditimi u konstatua se, Auditimi i Brendshëm në Raportin dhe Deklaratën mbi vlerësimin dhe funksionimin e MFK nuk ka përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar (neni 8), si dhe referuar Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 4.1:

Nëpunësi Autorizues të marrë masa që në vijim gjatë përpilimit të Deklaratës dhe Raportit Vjetor mbi Cilësinë e MFK-së, të përshkruaj gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe për vitin e raportimit, duke përfshirë edhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit, në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 5:

Nga auditimi u konstatua se, në Prokurorinë e Përgjithshme nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, me qëllim njohjen dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikën më të mira në fusha të ndryshme, edhe pse në strategjinë e menaxhimit të riskut, referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritare për institucionin, “trajnimi i stafit” është renditur ndër faktorët e parë. Sa më sipër mbështetet në kërkesat e Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Trajnimi dhe kualifikimi synojnë që të përgatisin punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 5.1:

Strukturat përgjegjëse (sipas hierarkisë nga poshtë-lart) të marrin masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartojnë dhe kryejnë trajnime specifike për punonjësve të administratës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin e nxjerrë në zbatim të tij (në veçanti për menaxhimin e riskut pasi u konstatua se, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e tij).

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 6:

Nga auditimi u konstatua se, Sektori i auditit të brendshëm gjatë 2 (dy) viteve objekt auditimi ka funksionuar vetëm me 2 (dy) punonjës, konkretisht një shëf sektori dhe një specialist, dhe jo sikundër kërkohet në pikën 3 (tre) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësisë të auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, i cili citon se “Njësia e auditit të brendshëm përbëhet jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”. Krijimi i plote i sektorit të auditit të

brendshëm ndikon në forcimin e komponentëve të Kontrollit të Brendshëm. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 21-29 në Raportin përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandimi 6.1:

Institucioni të marrë masa në krijimin e Sektorit të Auditit të Brendshëm me jo më pak se tre (3) punonjës, përfshirë edhe drejtuesin e njësisë, me qëllim që minimizimin e risqeve që mund të cenojnë kryerjen e funksioneve të njësisë së këtij sektori.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi nr. 7:

Nga auditimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se plani strategjik & plani vjetor gjatë periudhës objekt auditimi, nuk i është përmbajtur formatit sipas manualit të auditimit të brendshëm, i cili duhet të përmbajë Misionin, Vizionin, Objektivat strategjike, strategjinë e auditimit për një periudhë 3-5 vjeçare, sikundër kërkohet në Ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”; Urdhri nr. 100 datë 25.10.2016 për “Miratimin e Manualit të Brendshëm në sektorin Publik”. Ky plan përmban vetëm një pjesë të Formateve të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Hartimi i plotë i planit strategjik & vjetor merr rëndësi për nga impakti që ka në minimizimin e riskut dhe mbulimin me auditim të fushave/sistemeve, të cilat janë të ekspozuara ndaj risqeve kryesore në veprimtarinë e njësisë publike, gjatë periudhës trevjeçare. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 21-29 në Raportin përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandimi 7.1:

Sektori i auditit të brendshëm të marrë masa për të përgatitur Planin Strategjik dhe vjetor, me qëllim maksimizimin e përdorimit të burimeve të auditimit si dhe programimin efektiv të veprimtarisë, duke marrë në konsideratë një parashikim të mundur mbi mbulimin e risqeve kryesore gjatë një periudhe 3-5 vjeçare.

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 8:

Nga auditimi u konstatua se, në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën objekt auditimi nuk është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm, i cili jep garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të institucionit, sikundër kërkohet në nenin 13 të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. Krijimi i Komitetit të AB, ofron monitorim dhe këshillim për titullarin e njësisë, si dhe kryen funksion mbështetës për njësinë e auditimit, sa i takon vlerësimin e riskut dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 21-29 në Raportin përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandimi 8.1:

Prokuroria e Përgjithshme të marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Institucioni të krijojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm me qëllim sigurimin objektiv dhe këshillues për menaxhimin e projektuar, duke çuar në përmirësimin e veprimtarisë së njësisë publike.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi nr. 9:

Nga auditimi u konstatua se, në raportet e monitorimit për 4 muajt e vitit 2017, institucioni ka paraqitur: raportin sipas tabelave standarde të miratuara në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016; dhe relacionin shpjegues për mospërputhjet ndaj parashikimeve të periudhës raportuese; por nuk është shprehur mbi masat korigjuese që duhen ndërmarrë, sikundër e kërkon Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Mos plotësimi i kërkesave për monitorimin rrezikon të

cenojë procesin që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse për realizimin e tyre. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 45-49 në Raportin përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandimi 9.1:

Në përfundim të raportit të monitorimit për 4 mujorin e fundit të vitit, anëtarët e EMP të shprehen mbi masat që duhet të merren për veprime korigjuese në raste të mosrealizimit të planeve. Në rastet kur veprimet korigjuese shkojnë përtej përgjegjësisë së anëtarëve të EMP, por brenda përgjegjësisë së anëtarëve të tjerë në institucion ose edhe jashtë, duhet të përfshihen si rekomandime në relacionin e raportit të performancës edhe argumentet mbështetës. Sa më sipër duhet t'i paraqiten koordinatorit të GMS-së, jo më vonë se 15.12.2017 (jo më vonë se java e dytë mbas përfundimit të 4 mujorit), në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016.

Brenda datës 15.12.2017

Gjetje nga auditimi nr. 10:

Nga auditimi i pasqyrave financiare në Prokurorinë e Përgjithshme, u konstatua se, amortizimi për periudhën ushtrimore, është llogaritur mbi koston historike, pa zbritur amortizimin e akumuluar ndër vite, sikundër kërkohet në ligjin aktual fiskal nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, si dhe në Udhëzimin nr. 14, datë 28/12/2006

“Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj” dhe në Gjithashtu, është përlllogaritur amortizimi për disa mjete transporti si dhe për pajisje elektronike të blera në muajt Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2016, në një kohë që këto aktive nuk kanë qenë ende në përdorim, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku specifikohet se nuk fillon përlllogaritja e amortizimit deri sa asetet të jenë në dispozicion për përdorim. Konstatimet e sipërpërmendura edhe pse jo materiale për nga vlera dhe konteksti, ndikojnë në pasaktësinë e vlerës së reflektuar në pasqyrat financiare për amortizimin (është rritur me pa të drejtë llogaria 219). *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 10.1.:

Nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të merren masa të menjëhershme për ri llogaritjen e amortizimit të aktiveve mbi vlerën e mbetur, si dhe të rishikohet dhe të rillogaritet vlera e amortizimit për aktivet e bëra kalim kapitali, për vitin 2016, duke zbritur amortizimin e llogaritur tepër për pajisjet dhe makineri që nuk kanë qenë në përdorim nga institucioni.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi nr. 11:

Nga auditimi i pasqyrave financiare në Prokurorinë e Përgjithshme, u konstatua se, në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësim disa aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në vlerën 9,512,881 lekë, që përputhen me vlerën kontabël fillestare të regjistruar në kontabilitet. Nga auditimi u konstatua se për këto aktive nuk është zbritur vlera e amortizimit të akumuluar ndër vite për to, sikundër kërkohet në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke bërë që vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare të jetë më e lartë, se vlera aktuale e inventarëve. Kjo ka ndikuar në mos reflektimin e vlerës reale në llogarinë 219, duke sjellë pasaktësi jo materiale në pasqyrat financiare. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 11.1:

Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa të menjëhershme për të rilogaritur amortizimin e akumuluar ndër vite (llogaria 219) për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit, si edhe sistemimin dhe reflektimin e vlerave në llogarinë respektive.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi nr. 12:

Nga auditimi i llogarive kontabël ka rezultuar se vlera e mbetur e disa aktiveve, pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, rezulton të jetë zero, pavarësisht se aktivi është në përdorim dhe në gjendje pune. Nga PP nuk është bërë një vlerësim i jetës së dobishme të aktiveve, sikundër kërkohet në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, pika 103, duke ndikuar në mos pasqyrim e saktë të vlerës së aktiveve, gjendje në institucion. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 12.1:

Nëpunësi Autorizues duhet të ngrejë një komision për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen, duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 13:

Nga auditimi i fletë-daljeve të aktiveve nga magazina dhe çregjistrimi në kontabilitet, rezultoi se kalimi i mjeteve të transportit në pronësi të prokurorive të rretheve nuk është shoqëruar me urdhrin e kalimit në pronësi, si dhe nuk ka të bashkëngjitur autorizimin e personit për tërheqjen e mjetit, sikundër kërkohet në Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Një veprim i tillë, rrezikon procesin e monitorimit të sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 13.1:

Nëpunësi autorizues për çdo kalim kapitali duhet të nxjerre urdhrë për kalim pronësi të aktiveve, pasi është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë. Çdo lëvizje e aktiveve duhet të jetë e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin në momentin e transferimit të aktivitetit në pronësi të subjekteve përfituese.

Në vazhdimësi

Gjetje nga auditimi nr. 14:

Nga auditimi i fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës u konstatua se, në disa raste relacioni nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave është përgatitur pasi mallrat janë bërë hyrje në magazinë, dhe jo si kundër kërkohet në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50. Ky veprim shkakton risku se specifikat e mallit të marrë në dorëzim, të mos jenë në përputhje me kriteret e parashikuara. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 në Raportin përfundimtar të Auditimit*

Rekomandimi 14.1:

NA të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo marrje në dorëzim të aktiveve duhet që komisioni i ngritur të përpilojë procesverbalin nëse mallrat janë në përputhje me të dhënat e

verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, në përputhje me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.

Në vazhdimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R